



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2023:057021

Datë: 13.12.2023

Numri i dokumentit: 05059487

PPP.nr.944/2019

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Festim Zeqiri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorës Kolegji Iliria, me seli në Prishtinë, rruga “Gazmend Zajmi”, nr.75, kundër debitorës A.K nga Prishtina, Lagja ....., në çështje juridike përmbartimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorës, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit P.nr.732/19, të datës 04.04.2019, të lejuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Valdrin Beka në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 13.12.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET në tersi i bazuar prapësimi i debitorit A. K nga Prishtina, ashtu që:
- II. SHFUQIZOHET urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.732/2019 i datës 04.04.2019, i lëshuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Valdrin Beka në Prishtinë, anulohen të gjitha veprimet e kryera deri në këtë fazë të procedurës, si dhe përfundohet procedura përmbartimore.

**A r s y e t i m**

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat e Përmbartuesit Privat Valdrin Beka në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.732/2019 të datës 04.04.2019, me të cilin ka lejuar propozimin për përmbartim të kreditorit duke detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit ti paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 2,500.00€, me kamat ligjore prej 8% në vit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarisë bankare apo regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme.

Kundër urdhrin për lejim të përmbartimit, debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim përmes të cilit e ka kundërshtuar në tersi propozimin për përmbartim duke theksuar se vendimi nr.2700, si dokument mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përmbartimor nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 22 par.1.2 dhe nenit 23 par.2 të LPP-së, pasi që nuk ka tipare të

përmbaueshmërisë. Ka shtuar se borxhin të cilin e kërkon kreditori i përket periudhës së vitit 2007 ndërsa propozimi për përmbaueshmëri të kreditorit është i datës 03.04.2019 mbi këtë bazë ka theksuar se borxhi të cilin e kërkon kreditori është parashkruar në bazë të nenit 361 të LMD-së. Duke shtuar se debitori nuk ka diplomuar tek kreditori, nuk ka marrë asnjë diplomë apo certifikatë, por vetëm i ka ndërprerë studimet, i ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe të anulohet urdhri për lejim të përmbaueshmërisë.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim duke theksuar se i njëjti është i pabazuar në nenin 71 të LPP-së, vendimi 2700 në pjesën e fundit është i pajisur me klauzolë të formës së prerë dhe të ekzekutueshmërisë. Sa i përket parashkrimit të kërkesës ka theksuar se nuk ka parashkrim të kërkesës pasi që kërkesa e kreditorit duhet të kategorizohet në kërkesa që rrjedhin nga neni 361 të LMD-së ku afati i parashkrimit përcaktohet 10 vite kjo për faktin se debitori shërbimet i ka pranuar deri në vitin akademik 2009 - 2010. Duke shtuar se debitori ka bërë pagesat vetëm në shumë prej 1,100.00 euro, ndërsa ka dështuar që ta përmbushë edhe pjesën tjetër të borxhit si në propozim për përmbaueshmëri, i ka propozuar gjykatës të refuzohet i pathemeltë prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbaueshmërisë.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjen në prapësim të kreditorit dhe pas studimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar, nga këto arsye:

Dispozita nga neni 22 e Ligjit për Procedurën Përmbaueshmërisë përcakton llojet e dokumenteve përmbaueshmërisë (titujve ekzekutiv), mbi bazën e të cilave organi përmbaueshmërisë e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaueshmërinë në kuptim të nenit 21 të LPP-së. Kjo dispozitë parasheh që: *“Dokumente përmbaueshmërisë janë: 1.1. vendimi përmbaueshmërisë i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaueshmërisë; 1.2. vendimi përmbaueshmërisë i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia); 9 1.3. dokumenti noterial i përmbaueshmërisë në pajtim me ligjin për noterinë; 1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës; 1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbaueshmëri brenda territorit të Republikës së Kosovës; 1.6. vendimet dhe marrëveshjet përmbaueshmërisë të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata; 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit; 1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbaueshmërisë evropian; 1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbaueshmërisë.”*

Në rastin konkret, organi përmbaueshmërisë e ka lejuar përmbaueshmërinë bazuar në vendimin nr.2700, të dt.21.12.2007, të lëshuar nga ana e kreditorit, e që ka të bëjë me regjistrimin e studentit në vitin akademik 2007/2008. Gjykata vlerëson se një dokument i tillë nuk bën pjesë në ndonjë prej kategorive të dokumenteve përmbaueshmërisë, të numëruara me dispozitën e lartëcekur nga neni 22 e LPP-së, dhe si i tillë nuk i përmbushë kriteret e kërkuara për të shërbyer si dokument mbi bazën e të cilit mund të lejohet dhe caktohet përmbaueshmërisë.

Tutje qëndrojnë pretendimet e paraqitura nga debitorja në prapësim se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbaueshmërisë nuk paraqet akt administrativ. Interpretimi i Gjykatës konsiston në faktin se licencimi apo akreditimi për të ushtruar një veprimtari të caktuar nga ana e një autoriteti publik, nuk ia jep subjektit – në rastin konkret kreditorit cilësinë apo kompetencat e një organi administrativ. Rrjedhimisht, edhe vendimet e lëshuara nga ana e këtyre subjekteve nuk e kanë cilësinë e vendimeve të dhëna në procedurë administrative, në kuptim të dispozitës

nga neni 22 pika 1.2 të LPP-së, lidhur me nenin 82 e lidhur me nenin 2 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative. Nisur nga rrethanat e tilla, pretendimi i palës kreditore lidhur me përmbareshmërinë e dokumentit është pa mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi.

Dispozita nga neni 43 par.4 e LPP-së përcakton se: *“Përmbareshmit privat nxjerrin urdhrin për përmbareshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbareshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbareshmërisë së nxjerrë nga përmbareshi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbareshimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbareshi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbareshim nga përmbareshi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*. Mbi këtë bazë, gjykata në rastin konkret vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për lejimin e përmbareshimit nga përmbareshi privat, sepse është lejuar përmbareshimi mbi bazën e një dokumenti i cili rezulton se nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbareshimor (titullit ekzekutiv), andaj duke iu referuar dispozitës së lartëcekur, gjeti se pretendimet e parashtuara në prapësimin e debitorit janë të bazuara.

Nga sa u tha më lartë, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar në nenin 73 par.3 të Ligjit të Procedurës Përmbareshimore, ndërsa vendosjen për anulim të veprimeve dhe përfundim të procedurës përmbareshimore si në pikën II të dispozitivit, Gjykata e mbështet në nenin 73 par. 4 të Ligjit Nr.05/L-118 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbareshimore.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -  
PPP.nr.944/2019, dt.13.12.2023

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.